

# ***Sistemi i të Drejtës Civile në Kosovë: Përshtatja dhe Unifikimi i së Drejtës Civile me të Drejtën e Bashkimit Evropian***

Qerkin Berisha\*

## **Abstrakt**

*Përmes këtij punimi analizohet sistemi i së drejtës civile në Kosovë, përfshirë këtu degët e së drejtës civile për të shqyrtuar procesin nëpër të cilin po kalon e drejta civile në Kosovë dhe mënyrën e harmonizimit të saj me të drejtën e BE-së, duke pas parasysh proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Fusha e të drejtës civile dhe unifikimi i saj është një fushë e cila është kundërthënëse edhe brenda vetë BE-së, prandaj përmes punimit do të tentohet të analizohet ky proces në të dy rastet.*

*Punimi trajton në mënyrë krahasuese sistemin juridik të Kosovës në fushën e të drejtës civile, duke krahasuar me legjislacionin e BE-së të po kësaj fushe. Punimi synon të nxjerr konkluzione sa i përket sistemit të të drejtës civile në Kosovë dhe nivelit të harmonizimit të saj me të drejtën e BE-së, problemet, sfidat dhe të arriturat e tij. Përmes tij synohet të tregohet se sa ka arritur Kosova të rregullojë fushën e të drejtës civile, në veçanti fusha e të drejtës së detyrimeve, kontraktore, tregtare etj., e po ashtu edhe kërkesat e BE-së për harmonizim në këtë fushë. Duke pas parasysh që kjo fushë është tejet e gjerë, përmes këtij punimi problemi trajtohet në nivel parimor.*

**Fjalë kyçe:** e drejta civile në Kosovë; harmonizim i legjislacionit;

## **1 Hyrje**

Ky punim përbën një studim rreth procesit të harmonizimit apo edhe unifikimit të së drejtës civile në Republikën e Kosovës me të drejtën e Bashkimit Evropian, e në anën tjetër sipërfaqësisht trajton edhe vetë procesin e harmonizimit të së drejtës civile (private) në kuadër të Bashkimit Evropian dhe përpjekjet për të arritur drejt një kodifikimi të së drejtës civile në kuadër të Bashkimit Evropian. E drejta civile në kuadër të BE-së konsiderohet se është duke u zhvilluar me hapa të shpejtë gjatë viteve të fundit, dhe në këtë kuadër janë nxjerrë numër i madh i direktivave dhe

---

\* Asistent në lëndët juridiko civile në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe kandidat për doktoratë në fushën e së drejtës civile.

akteve tjera ligjore të BE-së. Po ashtu, edhe në nivelin kombëtar shumë ligje dhe akte tjera juridike janë nxjerrë nga vendet anëtare me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e BE-së. Edhe praktika gjyqësore është zhvilluar në këtë funksion, jo vetëm e mekanizmave të BE-së por, në veçanti e vendeve anëtare. Si tërësi mund të konsiderojmë se është njëra fushat më të gjera të së drejtës dhe me interes të lartë për BE-në, pasi ndërlihet drejtpërdrejtë me funksionimin e tregut të përbashkët të BE-së, dhe realizimin e lirive themelore. Në veçanti, legjislacioni që ka të bëjë me kontratat dhe të drejtën kontraktore, të drejtën tregtare-tregtar, të drejtat e detyrimeve janë ndër më të rregulluarat në kuadër të BE-së.

Duhet theksuar se procesi i unifikimit të së drejtës civile (private) në kuadër të vetë BE-së është një proces kontradiktor në shumë aspekte duke përfshirë bazën juridike, formën si dhe mënyrën e realizimit të tij. Kjo lë të nënkuptohet se edhe në kuadër të vetë vendeve anëtare të BE-së ka probleme të mëdha sa i përket një harmonizimi të plotë të fushës që mbulon e drejta civile. Rrjedhimisht, edhe Kosova ka dhe do të ketë para vetës edhe në të ardhmen një detyrë të vështirë së pari sa i përket asaj se deri në çfarë niveli do të duhet të shkojë me një harmonizim dhe unifikim të kësaj fushe dhe së dyti sa i përket vetë procesit i cili kërkon ekspertizë dhe kapacitete profesionale për të zbatuar këtë proces.<sup>1</sup> Me thellimin e proceseve integruese të Kosovës drejtë BE-së, edhe procesi i harmonizimit të legjislacionit në të gjitha fushat ka filluar të merret me më shumë seriozitet nga ana e institucioneve, në veçanti procesi i negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në shpresohet se do të ketë ndikimin e vet në një përshpejtim të harmonizimit të legjislacionit si dhe në cilësinë e tij.

Kur flasim për të drejtën civile në Kuadër të BE-së dhe çështjen e unifikimit të së drejtës Civile në Kosovë me atë të BE-së, termi, “*e drejtë civile*” i përdorur në këtë punim nënkupton “*të drejtën private*”, e cila në sistemin kontinental-Evropian përfshinë kontratat, të drejtat e obligacionit (detyrimet), pronësinë, të drejtën e kompanive si dhe të drejtën familjare dhe trashëgimore.<sup>2</sup> Kur jemi tek ajo se çfarë duhet përfshijë e drejta civile në mesin e teoricienëve ekziston një hamendje nëse ajo që sot në vendet e Evropës rregullohet përmes legjislacionit tregtar do duhej të ishte pjesë e një Kodi Civil Evropian.<sup>3</sup> Fusha e së drejtës tregtare, duke përfshirë

<sup>1</sup> Harmonizimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës me të Drejtën e BE-së deri më tani është bërë vetëm në nivel parimor, duke synuar që dispozitat ligjore të mos jenë në kundërshtim me parimet e së drejtës së BE-së, por ende nuk është kaluar në një proces të mirëfilltë të harmonizimit i cili mundëson një harmonizim të plotë të legjislacionit. Një gjë e tillë vërehet nga Deklaratat e Pajtueshmërisë të lëshuara nga Ministria e Integritimit Evropian, të cilat deri në vitin 2014 nuk kanë përmbajtur të dhëna specifike sa i përket krahasimit të dispozitave ligjore me legjislacionin përkatës të BE-së.

<sup>2</sup> Hondius, Ewoud, *Towards a European Civil Code*, in Hartkamp Arthur, Hesselink, Martijn, Hondius, Ewoud, Joustra, Carla, Perron, Edgar du, Veldman, Muriel (Eds) *Towards a European Civil Code*, Third Fully Revised and Expanded Edition, (Kluwer Law International 2004), në 6.

<sup>3</sup> Po aty.

mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit konsiderohet ndër më të unifikuarat në kuadër të Bashkimit Evropian, pasi rregullimi i saj është bërë nga një numër i madh direktivash. Prandaj edhe Legjislacioni i Republikës së Kosovës në këto fusha duhet që gradualisht të përshtatet me të drejtën e BE-së.

## **2 Sistemi i së Drejtës Civile në Kosovë: Historiku, Arritjet dhe Sfidat**

Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e së drejtës civile gjatë viteve të fundit ka pësuar ndryshime. Për më tepër, në periudhën nga viti 1989 e deri më sot, Kosova është ballafaquar me probleme të shumta në fushën e legjislacionit dhe zbatimit të tij, duke përfshirë këtu edhe fushën e së drejtës civile. Shumëllojshmëria e legjislacionit, problemet e trashëguara nga legjislacioni diskriminues i viteve 90-të<sup>4</sup>, transaksionet jo-formale pronësore<sup>5</sup>, prezenca e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, mungesa e kapacitetit profesional vendor në hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe probleme të tjera të ngjashme e kanë përcjellë Kosovën përgjatë kësaj periudhe.

Republika e Kosovës ende nuk ka bërë ndonjë vlerësim adekuat të ligjeve të saj duke përfshirë këtu edhe ligjet që mbulojnë fushën e së drejtës civile në fuqi për të parë se deri në çfarë shkalle ato janë në harmoni me *Acquis* të BE-së. Vetëm gjatë këtij vitit 2014 Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar me një vlerësim më të detajuar të legjislacionit të ri apo atij që është në proces të plotësimit ndryshimit. Është shumë e nevojshme që Kosova të ndërtoj një proces të mirëfilltë të transpozimit të legjislacionit të BE-së, të cilin Kosova si një vend që synon anëtarësimin në Bashkim Evropian duhet ta ketë në linjë me të. Për më tepër, duke pasur parasysh faktin se Kosova është duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me BE-në përmes marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërtimi i kapaciteteve të kësaj fushe është i domosdoshëm. Duke pasur parasysh se procesi integrues i Kosovës në BE është një proces i cili do të zgjasë disa vite, Kosova deri në fund të këtij procesi duhet të harmonizojë në tërësi legjislacionin e saj.

Legjislacioni aktual i Republikës së Kosovës në fushën e së drejtës civile mund të thuhet se është hartuar duke i respektuar parimet e së drejtës së Bashkimit Evropian. Në këtë proces, një kontribut të veçantë ka dhënë edhe Bashkimi Evropian përmes përkrahjes së drejtpërdrejtë gjatë hartimit të legjislacionit. Kjo nënkupton se ligjet që mbulojnë fushën e së drejtës civile janë të hartuara në frymën e Legjislacionit të BE-së dhe nuk i cenojnë parimet e tij. Sidoqoftë, Pajtuëshmëria me *Acquis* të BE-së nuk e nënkupton vetëm aspektin formal të hartimit të normave juridike të cilat janë në përputhje me dispozitat ligjore të BE-së.

<sup>4</sup> *Shih* Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë: *Sfidat në zgjidhjen e kërkesave pronësore që lidhen me konfliktin në Kosovë*, Qershor 2011, në 4, versioni elektronik në: <http://www.osce.org/sq/kosovo/80436?download=true>

<sup>5</sup> Po aty, në 5.

Ky proces është shumë më thelbësor dhe në vete përmban edhe zbatimin e tyre në praktikë në linjë me legjislacionin dhe praktikën përkatëse të BE-së dhe në mënyrë uniforme në të gjithë hapësirën evropiane për aq kohe sa legjislacioni i tillë evropian është në fuqi.<sup>6</sup>

Në këtë drejtim, kapacitetet institucionale dhe administrative në fushën e së drejtës civile në Kosovë që kanë të bëjnë me implementimin e të drejtave civile subjektive vlerësohet se ende janë të mangëta.<sup>7</sup> Prandaj, kur flasim për legjislacionin e Republikës së Kosovës në fushën që e mbulon e drejta civile apo më mirë të themi e drejta private edhe në rastet kur legjislacioni është në linjë me atë të BE-së, praktika e zbatimit të tij përcillet me probleme.

Zvarritja e zgjidhjes së kontesteve gjyqësore si rezultat i grumbullimit të mijëra lëndëve në gjykatat e Kosovës dhe në mekanizmat administrative, problemet me legjislacionin dhe zbatimin e tij<sup>8</sup>, zbatim i dobët i kontratave<sup>9</sup>, janë elemente që drejtpërdrejtë cenojnë disa nga liritë themelore të njeriut që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave pronësore si dhe me gjykimin e drejtë dhe efektiv. Vetë Komisioni Evropian përmes Raportit të Progresit për Kosovën të vitit 2014 vlerëson progres të ngadalshëm sa i përket respektimit të të drejtave pronësore në Kosovë.<sup>10</sup> I njëjti raport përmend përparimet që janë bërë sa i përket harmonizimit të legjislacionit të Kosovës në fushën e të drejtës së pronësisë intelektual dhe asaj industriale duke e konsideruar atë në linjë me *acquis*, sidoqoftë, edhe në këtë fushë janë vërejtur probleme sa i përket zbatimit të tij.<sup>11</sup> Problemet me legjislacionin në fushën e së drejtës pronësore si dhe me mekanizmat përkatës institucional ishin forcuar edhe me studimin e fisibilitetit të Komisionit Evropian lidhur me marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Edhe aty

---

<sup>6</sup> Gjykata Evropiane e Drejtësisë (ECJ) përmes praktikës së saj gjyqësore ka treguar se Legjislacioni nacional i cili është në kundërshtim me traktatet themelore të BE-së është i pazbatueshëm. Po ashtu, është konstatuar se edhe praktikën e zbatimit të të drejtës së BE-së në nivelin nacional duhet të jenë uniforme. Për më tepër shih: Hanson, Sharon, *Legal Method and Reasoning*, (Ed 2), (Cavendish Publishing Limited, London, 2003), në 417.

<sup>7</sup> Shih Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë: *Shqyrtimi i Rasteve të Pronësisë mbi Pronën e Paluajtshme në Kosovë*, Mars 2009, në 3-4, version elektronik në: <http://www.osce.org/sq/kosovo/36816?download=true>

<sup>8</sup> Shih: Commission Communication on a Feasibility Study for a Stabilisation and Association Agreement between the European Union and Kosovo, COM(2012) 602 final, në 12, versioni elektronik në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_analytical\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf)

<sup>9</sup> Shih: European Commission: *Kosovo Progress Report*, October 2014, në 39, version elektronik në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

<sup>10</sup> Po aty, në 19.

<sup>11</sup> Po aty, në 35.

theksohet nevoja për zvogëlimin e rasteve në gjykata si dhe respektimi i të drejtave pronësore.<sup>12</sup>

Marrëdhëniet pronësore vlerësohen me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e ekonomik të vendit. Situata aktuale sa i përket të drejtave pronësore në Kosovë ka efekte të drejtpërdrejta edhe në sistemin financiar, në veçanti sa i përket kredidhënies. Prandaj, Institucionet e Kosovës duhet që ta trajtojnë me prioritet reformimin e sistemit të drejtësisë dhe atij gjyqësor, të rrisin shkallën e përmbushjes së kontratave si dhe të reduktojnë zvarritjen e lëndëve nëpër gjykata.<sup>13</sup>

### **3 Cilat Janë Fushat më të Rregulluara që Mbulon e Drejta Civile dhe si Qëndron Kosova?**

Duhet theksuar se procesi për harmonizimin e të drejtës private që nga fazat e tij fillestare ka hasur në kontradikta nga ana e teoricienëve dhe politikanëve në nivel evropian. Disa nga ata e përkrahin një ide të tillë, si një proces që ndihmon në realizimin e funksioneve themelore mbi bazën e të cilave është themeluar Bashkimi Evropian dhe mendojnë se kjo duhet rregullohet në nivel të Bashkimit Evropian, ndërsa të tjerët mendojnë se fusha e së drejtës civile është sferë e cila duhet lënë vendeve anëtare që ta rregullojnë atë.

Deri më tani BE-ja ka arritur të rregulloj në nivel të BE-së mjaft mirë fushën që mbulon të drejtën e konsumatorit, dhe deri diku fushën e kontratave dhe të drejtës kontraktore, ndërsa, sa u përket çështjeve pronësore kjo fushë më tepër u është lënë vendeve anëtare që të vazhdojnë me zbatimin e ligjeve të tyre. Kjo nuk nënkupton se kemi dallime të mëdha në mes të vendeve në mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve pronësore (veçanërisht në sistemin kontinental), por secili nga vendet ka specifikat e veta.

Në vitin 2012 Kosova ka miratuar ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD)<sup>14</sup>. Për dallim nga legjislacioni i mëhershëm, ligji i ri konsiderohet se është më gjithëpërfshirës. Sidoqoftë, ende vazhdojnë të mbeten në fuqi disa dispozita të ligjit të ish-RSFJ-së. Ligji konsiderohet se është në linjë me legjislacionin e BE-së që përfshinë të drejtën kontraktore.<sup>15</sup> Dispozitat e tij vlerësohen se u mundësojnë individëve dhe bizneseve që të zhvillojnë lehtësisht raportet e tyre kontraktuale.<sup>16</sup>

<sup>12</sup> Shih: Commission Communication on a Feasibility Study for a Stabilisation and Association Agreement between the European Union and Kosovo, COM(2012) 602 final, në 12, versioni elektronik në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_analytical\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf)

<sup>13</sup> *Supra* nota 10, në 4.

<sup>14</sup> Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 16, 2012, version elektronik në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>

<sup>15</sup> Aliu, Abdulla, *E drejta Civile*, (Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2013), në 73.

<sup>16</sup> Po aty.

Normat e këtij ligji përmbajnë parimet themelore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e detyrimeve të tilla si autonominë e vullnetit të palëve, barazinë e palëve në marrëdhëniet e detyrimeve, ndalimin e shkaktimit të dëmit, ndalimi keqpërdorimit të të drejtave, detyrimi i përmbushjes së detyrimeve, ndershmëria dhe ndërgjegjshmëria dhe parime të tjera.<sup>17</sup> Këto parime janë të përfshira në pjesën e parë të ligjit nën kapitullin 'parimet themelore'. Siç u theksua edhe më sipër, edhe në kuadër të BE-së kjo fushë nuk është e harmonizuar si tërësi. Sidoqoftë, dispozitat e LMD-së janë në linjë me direktivat e kësaj fushe dhe po ashtu, edhe me parimet e së drejtës kontraktore. Përmbajtja e dispozitave të LMD-së sa u përket parimeve kryesore në fushën e marrëdhënieve të kontraktimit të përmendura më sipër është në linjë të plotë me tekstin e parimeve të së drejtës kontraktore evropiane, për shembull liria e kontraktimit, mirëbesimi dhe parime të tjera të ngjashme.<sup>18</sup> Problemet e përmendura në fillim të këtij punimi sa i përket funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe atij gjyqësor në Kosovë qëndrojnë edhe në fushën që mbulon e drejta e detyrimeve, në veçanti sa i përket përmbushjes së kontratave<sup>19</sup>, numrit të madh të kontesteve gjyqësore dhe të ngjashme.

Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Dendore(LPDTs)<sup>20</sup> është një ligj i cili rregullon fushën e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore. Sistemi i të drejtës civile në Kosovë i ngjason shumë sistemit Austriako-Gjerman dhe për më tepër edhe gjatë hartimit të LPDTs një ndikim të madh ka pasur e drejta Gjermane.<sup>21</sup> Edhe ky ligj konsiderohet një ligj i avancuar dhe rregullon në mënyrë të detajuar çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë, mënyrën e fitimit të saj, bartjes etj. Sidoqoftë, Kosova ka shumë probleme në fushën e pronësisë, duke filluar me problemet e trashëguara që kanë të bëjnë me pronësinë shoqërore, mosdefinimin e pronave, përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme për çështje pronësore etj, e deri tek ndërtimet pa leje që janë mjaft problematike për marrëdhëniet kontraktuale.

Kosova në vazhdimësi është ballafaquar me probleme edhe sa i përket të drejtave që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit dhe me pronësinë intelektuale në

---

<sup>17</sup> Shih Nenet 1 deri 14, Parimet Themelore të LMD-së. Po ashtu, Lidhur me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe përmbajtjen e dispozitave të tij shih: Dr. Nerxhivane Dauti; Avokat Ruzhdi Berisha, Avokat Adem Vokshi, Pronë Dr. Abdulla Aliu, *Komentari: Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, Libri I, (Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2013).

<sup>18</sup> Lando, Ole, Bale Hugh, (Ed) *Principles of European Contract Law Parts I and II*, (Kluwer Law International, 2000), 'Freedom of Contract, Article 1:102', në 99; 'Good Faith and Fair Dealing, Article 1:201', në 113.

<sup>19</sup> *Shih*: European Commission: *Kosovo Progress Report*, October 2014, në 39, version elektronik në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

<sup>20</sup> Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57, 2009, version elektronik në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2643>

<sup>21</sup> Pronë Dr. Haxhi Gashi, 'Fitimi dhe humbja e pronësisë sipas Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore: Influenca e Kodit Civil Gjerman në Ligjin e Kosovës', (2012) 2 *Revista e Drejta* 37.

përgjithësi, ndonëse edhe kjo fushë vlerësohet se sa i përket legjislacionit është e rregulluar në përputhje me legjislacionin dhe praktikën e BE-së. Ky konstatim rrjedh edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2014, i cili thekson se legjislacioni i kësaj fushe është i harmonizuar më tej me *acquis*.<sup>22</sup> E njëjta mund të thuhet edhe sa i përket fushës që ka të bëjë me pronësinë industriale.<sup>23</sup> Mekanizmat institucionale të themeluara për të zbatuar dispozitat ligjore të kësaj fushe edhe pse ekzistojnë ato kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve.

#### 4 Nevoja për një Kod Civil të Kosovës

Mënyrat e rregullimit të së drejtës civile përmes nxjerrjes së kodeve civile të cilat mbulojnë fushën e së drejtës civile janë të shpeshta në sistemin kontinental ku mbizotëron e drejta e shkruar. Ndër vendet fqinje të Kosovës, vlen të përmendet Shqipëria, e cila të drejtën civile e ka të rregulluar përmes Kodit Civil. Kjo mënyrë e rregullimit përveç që lehtëson zbatimin e dispozitave ligjore nga aspekti praktik, në të njëjtën kohë përbën një mënyrë të mirë për të shmangur kundërthëniet mes dispozitave ligjore në fushën e së drejtës civile.

Sistemi i së drejtës civile në Kosovë është një sistem që i ngjason sistemit Austriak-Gjerman, i cili ka qenë prezent në Kosovë edhe gjatë kohës së ish-Jugosllavisë. Prandaj, mënyra e rregullimit të raporteve juridiko-civile është pothuajse e ngjashme në të gjitha vendet e rajonit duke përfshirë këtu edhe Kosovën. Sidoqoftë, shumica e ligjeve kanë pësuar ndryshime.<sup>24</sup> Kosova ka një numër të madh të ligjeve që rregullojnë çështje të së drejtës civile<sup>25</sup> dhe për të bërë më të lehtë zbatimin e tyre, një proces kodifikimi i kësaj fushe do t'i kontribuonte një zbatim më të lehtë të tyre. Prandaj ideja e një Kodi Civil të Kosovës, duhet të shihet shumë seriozisht nga ana e institucioneve të drejtësisë në Kosovë.<sup>26</sup> Në procesin e mëtejshëm të rrugës integruese të Kosovës drejt Bashkimit Evropian, ky legjislacion që mbulon fushën e së drejtës civile duhet që të harmonizohet edhe më

<sup>22</sup> *Shih*: European Commission: *Kosovo Progress Report*, October 2014, në 35, version elektronik në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, 2012; Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, 2009; Ligji për Trashëgiminë, 2006; Ligji për Familjen, 2006; Ligji për Hipotekat, 2006; Ligji për Kadastër, 2011; dhe shumë ligje tjera.

<sup>25</sup> Aliu, Abdulla, *E drejta Civile*, (Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013), në 64-66.

<sup>26</sup> Nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës deri më tani nuk kemi ndonjë veprim formal me të cilin është inicuar hartimi i një Kodi Civil të Kosovës. Sidoqoftë, një projekt i përkrahjes teknike nga ana e Bashkimit Evropian për Ministrinë e Drejtësisë është prezantuar më 9 tetor 2014, i titulluar "Përkrahje për Kodin Civil dhe të Drejtat Pronësore" shih online deklaratën për media në: [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/press\\_releases/2014/141009\\_press\\_release\\_-\\_support\\_to\\_civil\\_code\\_and\\_property\\_rights\\_en.docx](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/press_releases/2014/141009_press_release_-_support_to_civil_code_and_property_rights_en.docx)

tej, e po ashtu edhe brenda vetë legjislacionit të Kosovës duhet të ndërmerren masa për unifikimin e tij.

Një proces i vlerësimit të përgjithshëm të fushës që mbulon e drejta civile është tejet i nevojshëm, së pari për të vlerësuar normat e fushës civile të cilat janë në fuqi në Republikën e Kosovës dhe së dyti për të shmangur dallimet mes ligjeve të veçanta në kuadër të fushës civile. Në procesin e përgatitjes së një Kodi Civil duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë edhe legjislacionit dhe praktikave të BE-së me qëllim që në të njëjtën kohë të bëhet një përafrim i kësaj fushe me *Acquis*. Sidoqoftë, nxjerrja e një Kodi Civil kërkon një angazhim të ekspertëve me përvojë nga fusha e së drejtës civile të cilët duhet që përveç njohurive për hartimin e një kodi civil gjithëpërfshirës të jenë njohës edhe të praktikës dhe marrëdhënieve shoqërore dhe ekonomike të Kosovës që mbulon fusha e së drejtës civile. Kjo do të mundësonte që dispozitat e një kodi civil të ardhshëm të zbatohen lehtësisht në praktikë duke përmirësuar situatën aktuale në fushën e së drejtës civile. Në të kundërtën, hartimi i një kodi civil pa analizuar këtë fushë në tërësi dhe pa pjesëmarrjen e ekspertëve të kësaj fushe nuk do të kishte ndonjë efekt në rregullimin e kësaj fushe.

## 5 Konkluzione

Legjislacioni dhe praktikat e BE-së në fushën e së drejtës private që nga themelimi i BE-së e deri më sot janë zhvilluar në vazhdimësi me qëllim të krijimit të një të drejte të unifikuar e cila zbatohet në hapësirën evropiane. Edhe pse nuk mund të flitet për një unifikim të plotë të kësaj fushe në kuadër të BE-së, pasi disa nga fushat që mbulon e drejta private deri më sot u janë lënë të drejtave kombëtare, një numër i madh i direktivave dhe rregulloreve janë nxjerrë me qëllim të aplikimit të tyre uniform në tërë hapësirën e BE-së.

Ndonëse në mesin e teoricienëve ekzistojnë dallime në atë se si duhet të bëhet unifikimi i së drejtës private në kuadër të BE-së, e po ashtu, edhe asaj se deri në çfarë mase duhet të shkohet me procesin e unifikimit të kësaj të drejte, shumica e teoricienëve vlerësojnë se e drejta private megjithatë duhet të unifikohet për t'i shërbyer tregut unik evropian dhe qëllimit të themelimit të BE-së. Vështruar nga aspekti legjislativ mund të themi se e drejta private në Evropë është në rrugë të vazhdueshme drejt unifikimit të saj.

Kur jemi tek e drejta civile në Republikën e Kosovës mund të vlerësojmë se janë shënuar përparime të theksuara në drejtim të përshtatjes së saj me legjislacionin dhe praktikat ekzistuese të BE-së, edhe pse në këtë fazë të integritimit në të cilën ndodhet Kosova nuk është e nevojshme që të kemi një unifikim të plotë. Kosova ka trashëguar probleme në fushën e së drejtës së pronësisë nga periudha e ish-Jugosllavisë duke përfshirë edhe legjislacionin diskriminues, pronësinë shoqërore dhe probleme tjera praktike në funksionimin e sistemit të të drejtës civile.



Aktualisht problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova në këtë fushë janë të ndërlidhura me funksionimin efikas të sistemit të drejtësisë.

Larmia e legjislacionit që shpeshherë shkakton edhe probleme në zbatimin e tij duhet që të adresohet përmes mundësisë së kodifikimit të fushës së të drejtës civile. Edhe pse deri më sot nuk ka ndonjë iniciativë zyrtare nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës për nxjerrjen e një Kodi Civil, kodifikimi i kësaj fushe do të mund të zgjidhte disa nga problemet dhe kundërthëniet që ekzistojnë në fushën e së drejtës civile. Krahas kësaj, ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të institucioneve të Kosovës të cilat merren me hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së është tejet i nevojshëm.